



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. 202/ Prot.

Tiranë, më 01.02. 2012

Drejtuar : SH.A "NPV"

DURRES

Lënda : Miratohet statuti i shoqërisë "NPV" Durrës.


Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria " NPV " Durrës, dërguar me tuaj shkresën nr.6 date 23.01.2012, konstatojmë se ai është hartuar ne zbatim te dispozitave te nenit 230 te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Për këto arsye bazuar ne Ligjin Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, nenin 216 e ne vijim te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", aksionari shtet i cili zotëron 100% te aksioneve te Sh.a "NPV" Durrës, miraton statutin e ri te shoqërisë.

Ngarkohet " NPV" Durrës, për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, Regjistrimi fillestar, neni 32,36.

MINISTRI

NASIP NAÇO



STATUTI

SHA "NPV"

Ne kete statut:

- "Ligji" eshte ligji Nr 9901, dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";

- "Statuti" eshte statuti i shoqerise;

- "aksionare" jane personat emrat e te cileve jane rregjistruar ne rregjistrin e aksioneve te shoqerise

si zoterues te aksioneve;

- "Dite te plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk e perfshin ditën kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditën per te cilen eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

Neni 1

Emertimi dhe selia

Shoqeria Anonime krijohet nga bashkimi i shoqerive "NPV nr 3" DURRES dhe "NPV nr 4" DURRES. Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet : "NPV" Sh.a Durres .Selia e shoqerise eshte ne Durres.

Neni 2

Objekti i Shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :Dhenie me qira e ambienteve dhe prodhim ,tregtim konfeksione.

Shoqeria brenda caqeve te parashikuara ne legjislacionin ne fuqi do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj . Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e siper marrjeve te tjera dhe pjesmarrie te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100% shtet me aksioner te vetem METE .Vlera e kapitalit themeltar te shoqerise eshte 66.781.000 leke. Numri i aksioneve eshte 66.781 . Vlera nominale e aksionit eshte 1.000 leke.

Neni 5

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi do te kryhet me urdher te Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizim.

Neni 6

Organet drejtuese te Shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- 1.Asambleja e aksionereve
- 2.Keshilli Mbikqyres
- 3.Administratoret

Neni 7

Keshilli Mbikqyres

1.Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3(tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes.

2.Kohezgjatja e funksionimit te tyre eshte 3 (vjet). Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithë te rizgjedhshem . Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura .

3.Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.

4.Nese nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje,shkarkimi ose doreheqje,zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3(tre) muaj . Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendeminin e nje anetari tjetër perfundon mandatin e paraardhesit.

5.Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes 65 (gjashtedhjetë e pese) vjec nuk mund te jene me shume se 1/3(nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Nese ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 8

Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar,te cilet therrasin mbledhjen e keshillit dhe drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithë kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar dhe jashte anetareve te tij . Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit,mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

Neni 9

Mbledhjet e keshillit mbikqyres

- (1) Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres do te mbahen te pakten dy here ne vit sipas nevojave te aktivitetit tregtar te Shoqerise, derisa Asambleja e Pergjithshme te vendose me shumice te zakonshme votash mbi shpeshtesine e ketyre mbledhjeve.
- (2) Vendimet e Keshillit Mbikqyres merren me kuorumin e percaktuar ne piken 5 te nenit 167 dhe nenin 162 te Ligjit. Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te marrin pjese ne

mbledhje nepermjet mjeteve elektronike te komunikimit perfshire komunikimin video dhe audio konference. Ata mund te marrin pjese ne votime duke perdorur numrin PIN te leshuar cdo anetari ne momentin e emerimit.

(3) Anetaret e Keshillit Mbikqyres emerone njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejtoje cdo takim te Keshillit Mbikqyres ne te cilin ai eshte i pranishem. Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda pese minutavenga orari i caktuar per mbledhjen, anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te emerone njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votive te pjesmarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.

(5) Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Keshillit Mbikqyres, ose komitetet e anetareve te Keshillit Mbikqyres, ose nga persona te cilet veprojne si anetare te Keshillit Mbikqyres, pavaresisht nese behet e ditur ne vijim se emerimi i anetarit te Keshillit Mbikqyres ka pasur mangesi ose keta anetare jane skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si anetare te Keshillit Mbikqyres dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha anetaret e Keshillit Mbikqyres te cilet kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e Keshillit Mbikqyres ose te nje komiteti te Keshillit Mbikqyres eshte nje lloj i vlefshem dhe i efektshem sikur te ishte miratuar ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres ose te komitetit te Keshillit Mbikqyres, te mbledhur dhe te zhvilluar rregullisht.

Neni 10

Kompetencat e keshillit mbikqyres

.Keshilli Mbikqyres nuk merr pjese ne administrimin e Shoqerise. Keshilli Mbikqyres vezhgon dhe mbikqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratoret dhe kontrollojne pajtuesmerine me kerkesat e Ligjit dhe te Statutit. Detyrat e Keshillit Mbikqyres te percaktuara nga pika 1 e nenit 167, shkronjat "b", "c", "d", "dh", "e", "f", "g", dhe "h" te pikes 1 dhe pika 2 e nenit 154 te ligjit nuk mund tu delegohen administratoreve.

.Keshilli Mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes lidhur me keto ceshtje:

- a)Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afat shkurter,afat mesem ,afat gjate te shoqerise.
- b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- c) Hapja e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
- d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
- e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera
- f) Marrjen e huave afatmesme dhe afatgjate .
- g) Si dhe cdo gje tjeter qe ne baze te Ligjit “Per shoqerite tregtare” eshte kompetence e asamblese se pergjithshme .

Neni 11

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne vendim te Keshillit te Ministrave.

Neni 12

Administratoret

- 1.Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- 2.Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakort jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe anetareve te ketij keshilli.
- 3.Anetaret e drejtorise jane persona fizike ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem.Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar i drejtorise ose administrator ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.

4..Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe 3(tre vjecare). Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.

5.Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem,ata nuk mund te jene mbi moshen 65(gjashtedhjetë e pese) vjec. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhjetë e pese) vjec konsiderohet I shkarkuar zyrtarisht.

6. Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne perputhje me VKM ne fuqi

Neni 13

Kompetencat e Administratoreve

Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen dhe Shoqeria do te perfaqesohet nga Administratoret te cilet mund te ushtrojne te gjitha komprtencat e tyre ne perputhje me parashikimet epikes 2 te nenit 167, shkronjave "a" ,"gj","h", dhe "l" te pikes 1 te nenit 154 dhe pikave 3 dhe 5 te nenit 158 te ligjit.

5.Lidhja e kontratave me afat mbi 2(dy) vjet dhe vlere mbi 2(dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.

6.Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

7. Drejtoria harton rregulloren e brendshme te shoqerise dhe e miraton ne keshillin mbikqyres.

Neni 14

Mbledhjet e Administratoreve

(1)Mbledhjet e Administratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar te Shoqerise.

(2) Vendimet e mbledhjes se Administratoreve merren kuorumin e votave qe mund qe mund te percaktohet nga Administratoret,dhe ne rast se ky kuorum nuk eshte percaktuar ai do te jete dy.

(3) Keshilli Mbikqyres cakton njerin prej Administratoreve me detyren e Kryetarit te mbledhjes se Administratoreve, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te

drejtoje cdo mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte i pranishem. Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte ipranishem brenda pese minutave nga ora e caktuar per mbledhjen, Administratoret e pranishem mund te emertojne njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesmarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.

(5) Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratoreve ose nga persona te cilet veprojne si Administratore, pavaresisht nese behet e ditur me vone se ka pasur mangesi ne emerimin e nje Administratori ose njeri prej tyre eshte ka qenei skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si Administratore dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nenshkruar nga te gjitha Administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjen e Administratoreve do te konsiderohet si i vlefshem dhe i efektshem njelloj si te ishte miratuar ne mbledhjen e Administratoreve, te mbledhur dhe zhvilluar rregullisht.

Neni 15

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetareve te drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres qofte e drejtperdrejte ose jo e drejtperdrejte duhet ti nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres. Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja . Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale. Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesa e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit .

Neni 16

Eksperti kontabel I autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga eksperte kontabel te autorizuar te cilet emerohen nga asambleja e aksionereve dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin .

Neni 17

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti . perfundimisht ushtrimi I pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar deri me date 31 dhjetor.

Neni 18

Inventari-llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise te saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

Neni 19

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem . Nga fitimet e ushtrimit te paksuar kur eshte rasti me humbjet e meparshme hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme. Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme, kur kjo rezerve arrin ne 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit. Perdorimi i fitimit behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes.

Neni 20

Emertimi i antareve te pare te keshillit mbikqyres

Si antare te pare te keshillit mbikqyres:

Znj. Suzana Stefa

Z. Denis Rrushaj

Z. Andrea Koxhaj

Neni 21

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Eksperti i pare I autorizuar emerohet:

Marie Dushi

Neni 22

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji nr .9901 date 14.04.2008 " per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri I Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes me cilesine e aksionerit te vetem.

Neni 23

Dispozita e fundit

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per Shoqerine Tregtare.

Date 01.01.2012.

MINISTRI

NASIP NACO

